



Periodiku AMF

Instalohet platforma e raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg

Pas një pune intensive prej më shumë se një vjeçare, AMF ka instaluar në ambientet e saj, platformën e re të raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg. Instalimi vjen pas përfundimit me sukses të fazës së katërt të një projekti të përbashkët të AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me financim nga Fondi i Ballkanit Perëndimor.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shkurt 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-shkurt 2010 arritën shifrën 1,380,294 mijë lekë, përkundrejt 1,254,774 mijë lekë të realizuara në janar-shkurt 2009 ose 10.00% më shumë.

Vijon në faqen 2

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar i enteve rregullatore të sigurimeve (Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), mars 2010)

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) njoftoi në mbyllje të mbledhjes së saj trevjeçare, në Bazel të Zvicrës, se dy autoritete të tjera mbikëqyrëse (Autoriteti i Tregjeve Financiare i Austrisë dhe Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve i Rumanisë) iu shtuan listës së palëve nënshkruese të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IAIS. Me këtë njoftim, numri gjithsej i palëve nënshkruese të Memorandumit ka arritur shifrën tetë.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet seminari "Mbi zbatimin e direktivës "Për marrjen në kontroll të shoqërive""

Komisioni Evropian në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, zhvilluan brenda kuadrit të instrumentit TAIEX më datë 29 mars 2010 në ambientet e Hotel Tirana International, në Tiranë, seminarin "Mbi zbatimin e direktivës "Për marrjen në kontroll të shoqërive"".

Vijon në faqen 5

Zhvillohet takimi "Krizat botërore: Sfidat dhe mësimet ekonomike për Evropën Juglindore"

DP e Çështjeve Ekonomike në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Institutin e Përbashkët të Vjenës, Austri, zhvilluan më 22 mars 2010 takimin "Krizat botërore: Sfidat dhe mësimet ekonomike për Evropën Juglindore".

Vijon në faqen 6

Edukimi i konsumatorit

Vijon nga numri i kaluar...

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut (Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore "Mbikëqyrja e Bazuar në Risk", me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

G. Çfarë nënkuptohet me "mbështetje shtesë" për siguruesit?

Deri tani, diskutimi është përqendruar te matja e riskut të mbetur. Edhe një sigurues me shkallë të lartë risku të mbetur, mund të mos përballet me medoemos me një risk të lartë dështimi, nëse ka kapacitetin për t'i absorbuar humbjet që lindin nga ngjarjet me risk të mbetur. Në këtë pjesë flitet për kapacitetin e siguruesit për t'i absorbuar këto humbje nga burimet e veta, si të tanishme ashtu edhe të ardhmen.

Vijon në faqen 7

Në këtë numër:

Instalohet platforma e raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **5**

Edukimi i konsumatorit **7**

Instalohet platforma e raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, gjatë takimit me përfaqësues të Vizor



Pas një pune intensive prej më shumë se një vjeçare, AMF ka instaluar në ambientet e saj, platformën e re të raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg. Instalimi vjen pas përfundimit me sukses të fazës së katërt të një projekti të përbashkët të AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me financim nga Fondi i Ballkanit Perëndimor.

Synimi i platformës AMF In-Reg është informatizimi i procesit të raportimit të shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në AMF.

Ndërtimi i saj është realizuar nga AMF në bashkëpunim me shoqërinë konsulente të përzgjedhur, Vizor, Irlandë, me përvojë të veçantë në realizimin e platformave të ngjashme të mbikëqyrjes financiare në vende të tjera si: Mbretëri e Bashkuar, Irlandë, Slloveni, etj.

Platforma garanton siguri dhe besueshmëri dhe rrit në të njëjtën kohë efektivitetin e procesit të raportimit prej shoqërive dhe të analizës së të dhënave nga autoriteti.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shkurt 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-shkurt 2010 arritën shifrën 1,380,294 mijë lekë, përkundrajt 1,254,774 mijë lekë të realizuara në janar-shkurt 2009 ose 10.00% më shumë.


Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 58.79% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 41.21% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 24.74% të sigurimeve të Jetës dhe 8.75% të sigurimeve të Jo-Jetës. 91.08% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 8.92% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës.

Gjatë 2-mujorit të parë të vitit 2010 u nënshkruan rreth 85,611 kontrata sigurimi, ose rreth 18.35% më pak se në janar-shkurt të vitit 2009.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2010




Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-shkurt (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Janar		
A) Sigurim i Jetës	98,704	123,123
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,156,069	1,257,171
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	688,904	568,785
b) Sigurimi Vullnetar	475,693	688,386
TOTAL	1,254,774	1,380,294

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-shkurt 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janar-shkurtit 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 41.21% të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për 2-mujorin 2010, arritën 424,562 mijë lekë, ose 5.15% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar-shkurt 2010, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 108,721 mijë lekë, ose rreth 49.61% më pak se në janar-shkurt 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-shkurtit 2010 arritën në 35,501 mijë lekë, apo 39.17% më shumë se në janar-shkurt 2009.

Sigurimet vullnetare

Në janar-shkurt 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 811,509 mijë lekë, ose 43.41% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.



Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 688,386 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 39.68% të pasuara nga sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 29.62%, sigurimi kasko me 13.85% dhe dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-shkurt 2010, arritën në 55,583 mijë lekë, 9.39% më pak se në janar-shkurt 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 63.98% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-shkurt 2010 arritën në rreth 123,123 mijë lekë, ose rreth 24.74% më shumë se në janar-shkurt 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 29.99% të primeve



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 50.90% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-shkurt 2010 kapi vlerën 314,285 mijë lekë, ose 32.45% më shumë se në janar-shkurt 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit të detyrueshëm me 208,942 mijë lekë, apo 66.48% të totalit.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar i enteve rregullatore të sigurimeve

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), mars 2010)

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) njoftoi në mbyllje të mbledhjes së saj trevjeçare, në Bazel të Zvicrës, se dy autoritete të tjera mbikëqyrëse (Autoriteti i Tregjeve Financiare i Austrisë dhe Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve i Rumanisë) iu shtuan listës së palëve nënshkruese të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IAIS. Me këtë njoftim, numri gjithsej i palëve nënshkruese të Memorandumit ka arritur shifrën tetë.

Palët që kishin nënshkruar më parë memorandumin janë: Autoriteti Rregullator i Australisë; Autoriteti Monetar i Bermudës; Komisioni Mbikëqyrës Financiar i Taipei Kinez; "Autorité de Contrôle des Assurances et des Mutuelles" i Francës; Autoriteti Mbikëqyrës Financiar Federal (BaFin) i Gjermanisë; dhe "De Nederlandsche Bank" e Vendeve të Ulëta.

Memorandumi është një kuadër për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe vendos standardet minimale që duhen respektuar nga palët nënshkruese për të përmirësuar efektivitetin e mbikëqyrjes ndërkufitare të shoqërive të sigurimit. Gjithashtu, pritet që ky Memorandum të ndihmojë në përpjekjet globale në drejtim të rregullimit sistematik të institucioneve të rëndësishme financiare.

Sipas Z. Peter Braumüller, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS, "IAIS është fuqimisht e angazhuar për nxitjen e bashkëpunimit mbikëqyrës dhe shkëmbimit të informacionit dhe rritja e qëndrueshme e enteve që kërkojnë të bëhen palë nënshkruese të Memorandumit është dëshmi e pranimit gjithnjë e në rritje të këtij Memorandumi

mes enteve mbikëqyrëse të sigurimeve."

Zhvillohet seminari "Mbi zbatimin e direktivës "Për marrjen në kontroll të shoqërive""

Komisioni Evropian në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, zhvilluan brenda kuadrit të instrumentit TAIEX më datë 29 mars 2010 në ambientet e Hotel Tirana International, në Tiranë, seminarin "Mbi zbatimin e direktivës "Për marrjen në kontroll të shoqërive"".

Seminari pati si qëllim prezantimin e Direktivës së BE-së duke u fokusuar në drejtim të ofertave për marrjen në kontroll të shoqërive, rëndësinë e zbatimit të direktivës, kompetencat e Autoritetit Rregullator, eksperiencat nga vendet e tjera që kanë zbatuar direktivën e lartpërmendur, si dhe rekomandimet në zbatimin e saj.

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, e cila vuri theksin në rëndësinë e miratimit të Ligjit nr. 10236, datë 18.2.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive publike", risitë që sjell ky ligj, si dhe rolin e AMF-së e rregullatorëve të tjerë në mbikëqyrjen e procesit të marrjes në kontroll. Në vijim, eksperiencat dhe reformat e ndërmarra nga vende si Italia, Gjermania, Greqia dhe Letonia u prezantuan nga ekspertë nga vendet në fjalë, të cilët bënë dhe analiza të detajuara të legjislacionit evropian që lidhet me këtë fushë specifike.

Në seminar morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministria e Integritimit.

Temat u ndoqën me mjaft interes nga të pranishmit dhe pati mjaft pyetje e diskutime.

Zhvillohet takimi “Kriza botërore: Sfidat dhe mësimet ekonomike për Evropën Juglindore”

DP e Çështjeve Ekonomike në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Institutin e Përbashkët të Vjenës, Austri, zhvilluan më 22 mars 2010 takimin “Kriza botërore: Sfidat dhe mësimet ekonomike për Evropën Juglindore”.

Informacion i përgjithshëm për programin

Rënia ekonomike globale, e paprecedent qysh prej Luftës së Dytë Botërore, ka pasur një efekt të thellë, paçka se asimetrike, në ekonominë e zhvilluara dhe ato të sapolindura evropiane. Lidhjet tregtare, të investimeve të huaja dhe të sektorit bankar, midis këtyre dy grupeve të vendeve kanë rrënjë të thella, integrimi i tregut të punës, migrimi dhe dërgesat private nga jashtë po rriten, ndërsa kërkesat ligjore të “*acquis communautaire*” janë orientimi i zhvillimit institucional në Evropën e re. Zvogëlimi i flukseve hyrëse të kapitalit në Evropën e re, pas një periudhe të gjatë kushtesh të jashtme të favorshme, dhe çekuilibrat e jashtëm në rritje, po i detyrojnë shumë vende të bëjnë një përshtatje fiskale të jashtme, çka ka rrjedhoja të shumta për ritmin e konvergencës reale dhe nominale në Evropën e re dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

Në këtë seminar të nivelit të lartë u mblodhën politikbërës nga BE dhe vendet partnere të tij nga kjo Evropë e re, të cilët evidentuan situatën dhe diskutuan për strategjitë e daljes nga kjo situatë, duke vënë theksin te zhvillimet dhe perspektivat për Evropën Juglindore. Disa prej pyetjeve që diskutuan pjesëmarrësit gjatë seminarit ishin:

- o Cilat qenë kushtet makroekonomike dhe strukturore përpara krizës në Evropën e re?
- o A kanë qenë të paqëndrueshëm në periudhën afatgjatë deficitet e mëdha të llogarisë korrente, huamarrja në monedhë të huaj e pambrojtur dhe zhvillimi i vrullshëm i

sektorëve financiarë në Evropën e re, apo kjo krizë është një ndërprerje jetëshkurtër e rikuperimit të kohës dhe e konvergencës reale?

- o A kanë qenë kuadret makroekonomike dhe regjimet rregullatore të sektorëve financiarë në Evropën e re në lartësinë e detyrës së mbrojtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar?
- o A janë këto përgjigje të politikave të afta për t'u dhënë zgjidhje rrënjëve të vështirësive me të cilat përballet Evropa Juglindore? Cilat janë mësimet kryesore që mund të nxirren për trajtimin e nevojës për reforma më të thella e të afta për të mbrojtur stabilitetin në të ardhmen? A e ka prekur kriza hapin e reformave në Evropën e re?
- o Cilat janë perspektivat e konvergencës reale dhe nominale të Evropës Juglindore dhe vendeve të tjera të Evropës së re, në pasojat që ka lënë kriza? Cilat janë ndryshimet që do të kërkonte kriza globale për strategjinë e rritjes ekonomike në Evropën Juglindore?

Në përgjigje të këtyre çështjeve të gërshetuara, në **Seancën e Parë** u trajtuan zhvillimet ekonomike në ekonominë e reja të Evropës, duke parë rezultatet krahasuese të Shteteve të reja Anëtare, vendeve të Evropës Juglindore dhe ekonomive të reja të Evropës përpara dhe gjatë krizës. Në të do të analizohen tiparet kryesore dhe efektet e krizës globale dhe kanalet e transmetimit të krizës drejt ekonomive të reja të Evropës dhe vendeve të Evropës Juglindore, duke treguar vëmendje të veçantë për rolin e sektorit financiar.

Në Seancën e Dytë u trajtuan përgjigjet afatshkurtra të politikave ndaj krizës, duke vlerësuar instrumentet makroekonomike monetare dhe fiskale.

Në Seancën e Tretë u trajtuan mësimet që mund

të nxirren nga ndërtimi dhe vënia në zbatim e programeve të mbështetura nga FMN për nxjerrjen e disa udhëzuesve për hartimin e strategjive për daljen nga kjo situatë në Evropën Juglindore dhe për vlerësimin e rolit të bashkërendimit ndërkombëtar, duke folur për përfitimet e platformave joformale për plotësimin e hendekut të financimit, përballimin e përbashkët të barrës midis vendeve pritëse dhe bankave ndërkombëtare (“nisma e Vjenës”).

Një **Panel i Përgjithshëm** ekspertësh diskutuan për perspektivat dhe strategjitë në Evropën Juglindore për rikthimin e rritjes së qëndrueshme

Edukimi i konsumatorit

Vijon nga numri i kaluar...

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut

(Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore “Mbikëqyrja e Bazuar në Risk”, me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

G. Çfarë nënkuptohet me “mbështetje shtesë” për siguruesit?

Deri tani, diskutimi është përqendruar te matja e riskut të mbetur. Edhe një sigurues me shkallë të lartë risku të mbetur, mund të mos përballet me medoemos me një risk të lartë dështimi, nëse ka kapacitetin për t'i absorbuar humbjet që lindin nga ngjarjet me risk të mbetur. Në këtë pjesë flitet për kapacitetin e siguruesit për t'i absorbuar këto humbje nga burimet e veta, si të tanishme ashtu edhe të ardhshme.

Megjithëse, shumica e legjislacionit për sigurimet përmban kërkesa ligjore që siguruesi të mbajë kapital në mënyrë që ta mbrojë nga humbjet e papritura, mënyra me të cilën përmbushet kjo kërkesë ndryshon në mënyrë mjaft të konsiderueshme. Disa legjislacione kërkojnë një vlerë fikse, disa ligje kërkojnë një

përqindje të ponderuar me riskun të aktiveve të bilancit kontabël të siguruesit, ndërsa legjislacionet më të sofistikuara u kërkojnë siguruesve të mbajnë kapital të mjaftueshëm në përpjesëtim të drejtë me risqet e biznesit, si për një vlerë minimale të caktuar. Për hir të këtij diskutimi, kërkesën ligjore e quajmë *kërkesa për kapitalin minimal (KKM)*.

Sipas qasjes së MBR-së (*Mbikëqyrjes me Bazë Riskun*), mbikëqyrësi përqendrohet në katër aspekte: tepricën e kapitalit mbi KKM-në, cilësinë e kapitalit, mundësinë e siguruesit për të gjetur kapital shtesë dhe fitimet e tij.

Sigurisht, sa më e madhe të jetë diferenca pozitive midis kapitalit dhe KKM-së, aq më e madhe është mundësia e tij për t'u bërë ballë humbjeve të papritura.

Mirëpo, jo të gjithë instrumentet e kapitalit janë të barabartë dhe ky fakt i kërkon mbikëqyrësit të shqyrtojë cilësinë e secilit zë që konsideron si kapital siguruesi. Shembulli që haset më shumë është borxhi i pasiguruar i cili është thujse kapital, qëndron sipër aksioneve të zakonshme dhe, përgjithësisht, pranohet si instrument kapitali me cilësi më të ulët se aksioni i zakonshëm. Jo të gjithë regjimet rregullatore e mbajnë parasysh këtë formë thujse kapitali.

Një faktor i rëndësishëm në diskutimin për kapitalin është mundësia që kanë siguruesit për të gjetur kapital shtesë, nëse lind nevoja. Vlerësimi i kësaj mundësie të siguruesve kërkon që mbikëqyrësit të kuptojnë mënyrën me të cilën e administrojnë kapitalin e vet siguruesi, çfarë planesh rezervë ka për të gjetur kapital shtesë nëse lind nevoja dhe gatishmërinë dhe mundësinë e aksionarëve për të nënshkruar shumën të tjera, sidomos aksionarët e mëdhenj. Kjo ka sidomos rëndësi në ato raste kur siguruesi bën pjesë në një grupim financiar, nëse mbështetet te subjektet e tjera brenda grupit për mbështetje me kapital.

Në fund, mbikëqyrësit që përdorin MBR-në duhet të shikojnë edhe fitimet për kapital, për dy arsye. Fitimet mundësojnë absorbimin e humbjeve dhe rivendosjen e rezervave të pakësuara nga humbjet e papritura. Në përgjithësi, tregjet nuk i duan ato shoqëri tregtare të cilat sjellin fitime shumë të luhatshme për aksion nga njëra periudhë financiare në tjetrën. Kështu që mendimi i tregut është njëfarë dëshmie e mundësisë së siguresit për të gjetur kapital shtesë. Në kuadër të qasjes së MBR-së, mbikëqyrësi shikon fitimet ushtrimore për aksion dhe parashikimet për të ardhmen dhe krijon një ide nëse fitimet ushtrimore vijnë vetëm nga operacionet dhe nëse parashikimet janë realiste dhe të mbështetura në ecurinë në të shkruarën dhe planet tregtare për të ardhmen.

Vlen të theksohet se në vendet e zhvilluara, kërkesat për kapitalin minimal po fillojnë të bazohen në risk. Kjo ka ardhur, pjesërisht, si rezultat i një qasjeje MBR-je, e cila mat mjaftueshmërinë e kapitalit e kërkon një masë që përputhet më shumë me profilin e riskut të siguresit. Këshillave administrativë të siguresve në vendet që do të fusin në përdorim kërkesat për kapital “Solvency II” do t’u kërkohej të mbajnë kapital minimal në përpjesëtim me riskun e siguresit dhe të administrojnë marrëdhënien midis kapitalit dhe riskut. Mbikëqyrësit në këto vende do të kenë detyrimin për të vendosur MBR të veçanta në lidhje me karakteristikat e riskut të secilit sigures. Kjo qasje pasqyron kërkesat për bankat, në kuadër të marrëveshjes për kapitalin Bazeli II. Për autoritetet mbikëqyrëse në vendet që përdorin “Solvency II”, MBR ka rëndësi parësore.

Siguresit në vendet që zbatojnë “Solvency II” do të duhet të vendosin disa masa formale për vlerësimin e riskut. Vlerësimi i siguresit do të japë një kontribut të çmueshëm për vlerësimin e mbikëqyrësit dhe negociatat me siguresit për kërkesën për kapitalin minimal. Megjithatë, është mirë që agjencitë mbikëqyrëse në vendet që nuk do përdorin “Solvency II” t’i nxisin siguresit ta

formalizojnë vlerësimin dhe administrimin e riskut nga ana e tyre.

H. Sa shpesh duhen shqyrtuar vlerësimet e riskut?

Përgjigja e shkurtër është sa herë që agjencia mbikëqyrëse merr informacion për një sigures. MBR është një proces dinamik dhe vlerësimi i rrezikut duhet të shqyrtohet pas çdo shqyrtimi dokumentar dhe shqyrtimi në vend. Kur në vëmendje të mbikëqyrësit vijnë informacione të tjera, kjo duhet të shkaktojë fillimin e një shqyrtimi të vlerësimit të riskut nga mbikëqyrësi. Një shembull i kësaj është rasti kur bie vlerësimi i jashtëm i aftësisë kredimarrëse për një risigures apo një klient të madh, qasja MBR u kërkon mbikëqyrësve të shqyrtojnë vlerësimin e riskut të kredisë të gjithë siguresve që janë të ekspozuar ndaj risiguresit apo korporatës në fjalë.

I. Kalimi drejt MBR-së

Autoritetet mbikëqyrëse, të cilat duan të vendosin në zbatim një qasje mbikëqyrëse të bazuar në risk, duhet ta planifikojnë me kujdes kalimin drejt saj. Megjithëse ka shumë avantazhe për këtë qasje, ka edhe disa risqe. Risqet kryesore lindin nga realizimi me nxitim i kalimit drejt qasjes së re dhe pa planifikimin e duhur.

MBR u kërkon mbikëqyrësve të ushtrojnë gjykim që të jetë më subjektiv nga ato me të cilët janë mësuar të bëjnë më parë. Për shembull, në kuadër të MBR-së mbikëqyrësit do të shikojnë planin e biznesit të një siguresi dhe do të përpiqen të vlerësojnë se çfarë pasojash (pozitive dhe negative) mund të ketë plani i biznesit, mbi kapitalin e siguresit. Qasja në bazë të zbatimit të normave përqendrohet më shumë në sasinë dhe cilësinë e kapitalit të tanishëm të siguresit kundrejt kërkesave të përcaktuara me ligj. Është thelbësore që mbikëqyrësve t’u jepet kohë dhe trajnim i mjaftueshëm për ta bërë me sukses kalimin.

Një prej avantazheve të MBR-së është se mundëson krahasimet e profileve të risqeve të siguruesve të ndryshëm në sektorin përkatës të ekonomisë dhe tregon se si zhvillohen me kalimin e kohës profilet e riskut të siguruesve të veçantë. Ky avantazh mund të përfitohet vetëm nëse ka një nivel të lartë përputhshmërie në qasjet e mbikëqyrësve të veçantë dhe drejtuesve të tyre lidhur me vlerësimin e risqeve. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të përgatisin dhe testojnë materiale udhëzuese për mbikëqyrësit lidhur me përbërësit e risqeve dhe sistemeve të kontrollit në nivele të ndryshme.

Njëri prej synimeve të MBR-së është të mundësojë kapjen e profilit të riskut të një siguruesi. Kjo bëhet duke përdorur një model të vlerësimit me pikë të riskut. Zbatimi me sukses i MBR-së varet nga projektimi, testimi dhe vënia në zbatim e një modeli të përshtatshëm të vlerësimit me pikë të riskut.

Shumica e mbikëqyrësve që kanë filluar të përdorin një qasje të bazuar në risk, e kanë futur në zbatim shkallë-shkallë dhe paralelisht me qasjet ekzistuese që ndjekin. Vetëm pasi kanë fituar besim te aftësia e mbikëqyrësve të tyre për të bërë gjykime të shëndosha të riskut dhe te besueshmëria e instrumenteve të tyre të matjes, atëherë ato kthehen tërësisht në qasjen e bazuar në risk. Ky është një shembull që tregon se si përpiqen ta minimizojnë riskun e tyre autoritetet-riskun e mbikëqyrjes jo të efektshme.

L. Mbikëqyrja dhe kriza globale financiare

Viti 2008 do të shënohet në histori si fillimi i krizës financiare globale, e cila ka sjellë dështime në shumë institucione financiare dhe qeveri, të cilave u është dashur t'i mbështesin këto institucione financiare që janë konsideruar si tepër të rëndësishme për sistemin për të mos i lënë të dështojnë. Debati për shkaqet dhe nëse

mund të ishte evituar apo jo kriza do të vazhdojë për shumë vjet. Njëfarë kritike është shprehur tashmë në drejtim të mbikëqyrësve, sepse nuk kanë arritur të kujdesen që institucionet t'i kuptojnë dhe trajtojnë risqet që marrin përsipër dhe sepse nuk kanë arritur të sigurojnë që institucionet të mund të gjejnë kapital nga burime konvencionale kur t'i lindë nevoja. Vetëm koha do ta tregojë nëse këto kritika janë apo jo të justifikuara, por kriza përmban, megjithatë, mësim për mbikëqyrësit sa i takon maturisë së mbështetjes të gjykimi i të tretëve dhe nevojës për t'iu qasur mbikëqyrjes me përvojë, dije dhe, ç'është më e rëndësishmja, me një shkallë të shëndetshme skepticizmi. Kjo është po aq e vërtetë, si kur mbikëqyrja bazohet te respektimi i normave, ashtu edhe kur ajo bazohet te risku.

Për këtë numër punuan:

**E. Shehi, R. Guri,
P. Berberi, E. Kokona**

